

URDHËR
Nr. 64, datë 12.3.2026

MBI CAKTIMIN E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM
NDËRINSTITUCIONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 19.12.2025, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”,

URDHËROJ:

1. Caktimin e znj. Ami Çarçani, me detyrë drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Publike dhe Migracionit, kryetare të Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 19.12.2025, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, si organi epror, i cili shqyrton ankimimin administrativ të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga grupi i identifikimit formal për dhënien ose jo të statusit të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit.

2. Kryetari i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional do të ushtrojë funksionin në përputhje me detyrat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 19.12.2025, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit, për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Publike dhe Migracionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari